



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА - РЕПУБЛИКА Е МАКЕДОНСKE СЕ ВЕРИУТ
АГЕНЦИЈА ЗА СУПЕРВИЗИЈА НА КАПИТАЛНО
ФИНАНСИРАНО ПЕНЗИСКО ОСИГУРУВАЊЕ
АГЈЕНЦИА ПËР МБИКËQYРЈЕ ТË ФИНАНСИМИТ
КАПИТАЛ ТË СИГУРИМИТ ПЕНСИОНАЛ
Бр. № 01-736/4
15.05 2026 год.-VII
СКОПЈЕ - ШКУР

Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional.

RAPORTI VJETOR PËR PUNËN E AGJENCISË PËR MBIKQYRJEN E FINANCIMIT KAPITAL TË SIGURIMIT PENSIONAL NË VITIN 2025

Shkup, maj 2026

Përmbajtja

HYRJE.....	4
1 ORGANIZIMI DHE FINANCIMI I AGJENCISË PËR MBIKQYRJEN E FINANCIMIT KAPITAL TË SIGURIMIT PENSIONAL.....	6
1.1 SKEMA ORGANIZATIVE E AGJENCISË	6
1.2 PUNA E KËSHILLIT TË EKSPERTËVE TË AGJENCISË	8
1.3 FINANCIMI I AGJENCISË	11
2 AKTIVITETET E REALIZUARA NË PERIUDHËN RAPORTUESE	12
2.1 SUPERVIZIMI I SHOQËRIVE PENSIONORE DHE FONDET PENSIONORE	12
2.1.1 Supervizimi jashtë-terrenit	12
2.1.2 Kontrolli në terren i shoqërive pensionore dhe fondeve pensionore	15
2.1.3 Komiteti për vlerësimin e rreziqeve	16
3 FUNKSIONI RREGULLATOR DHE PROCEDURAT	17
3.1 AKTE NËNLIGJORE	17
3.2 MIRATIMET DHE PËLQIMET	18
3.3 KOMISIONI PËR VENDOSJE MBI KUNDËRVAJTJE	19
4 VEPRIMET LIDHUR ME TË DREJTAT E ANËTARËVE, ANKESAT DHE PROPOZIMET	19
4.1 NJOFTIMI I PERSONAVE TË SHPËRNDARË PËRGJITHMONË DHE PËRKOHËSISHT NË FONDIN PENSIONOR TË OBLIGUESHËM	19
4.2 VEPRIMET SIPAS KËRKESAVE	20
4.3 VEPRIMET SIPAS ANKESAVE DHE PROPOZIMEVE	20
5 AKTIVITETET LIDHUR ME AGJENTËT E SHOQËRIVE PENSIONORE	20
6 ZHVILLIMI I VETËDIJES SË PUBLIKUT PËR QËLLIMET DHE PARIMET E SIGURIMIT PENSIONOR TË FINANCUAR ME KAPITAL DHE TË DREJTAT E ANËTARËVE TË FONDEVE PENSIONORE	21
7 ANALIZA STATISTIKORE DHE PËRGATITJA E RRAPORTEVE PËR SIGURIMIN PENSIONOR TË FINANCUAR ME KAPITAL	25
8 NDËRTIMI DHE PËRFORCIMI I KAPACITETEVE TË AGJENCISË	26
8.1 PJESËMARRJA NË SEMINARE DHE KONFERENCA DHE TRAJNIME TË SPECIALIZUARANË VEND DHE JASHTË VENDIT	26
8.2 ZHVILLIMI I PROCESEVE TË BIZNESIT DHE KAPACITETIT INFORMATIK TË AGJENCISË	27
8.3 SISTEMI I INTEGRITETIT	28
8.4 BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONE DHE ORGANIZATA NGA VENDI DHE JASHTË VENDIT	28 2
8.5 BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONE NGA VENDI	29
8.6 BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONE NGA JASHTË VENDIT DHE ME ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE	31
9 MISIONI I EKSPERTËVE TAIEK VLERËSIMI I REZISTENCËS EKONOMIKE TË SIGURIMIT PENSIONOR TË FINANCUAR ME KAPITAL	32
10 SISTEMI PËR MENAXHIMIN ME CILËSINË DHE SISTEMI PËR MENAXHIMIN ME SIGURINË E INFORMACIONEVE	33

HYRJE

Agjencia për mbikqyrjen e financimit kapital të sigurimit pensional (në tekstin e mëtejshëm: „Agjencia“) është themeluar në bazë të Ligjit për sigurim pensionor të obligueshëm të financuar me kapital („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ numër 29/2002, 85/2003, 40/2004, 113/2005, 29/2007, 88/2008, 48/2009, 50/2010, 171/2010, 36/2011, 98/2012, 13/2013, 164/2013, 44/2014, 192/2015, 30/2016 dhe 21/2018) dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ numër 180/2019, 103/2021 dhe 86/2025) (në tekstin e mëtejshëm: „Ligji“). Sipas nenit 46 të Ligjit, Agjencia është trup rregullator i pavarur dhe autonom dhe ka cilësinë e personit juridik me autorizime publike të përcaktuara me këtë ligj dhe me statutin. Emri i shkurtuar i Agjencisë, i përcaktuar me statut, është MAPAS. Organi i saj është Këshilli i ekspertëve, ndërsa për punën e saj përgjigjet para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Qëllimi i themelimit të saj është mbrojtja e interesave të anëtarëve dhe të anëtarëve të pensionuar të fondeve pensionore dhe nxitja e zhvillimit të sigurimit pensionor të financuar me kapital.

Kompetencat e Agjencisë janë të përshkruara në nenin 47 të Ligjit dhe ndër kompetencat tjera, Agjencia kryen punët në vijim:

- lëshon, tërheq dhe merr leje për themelimin e shoqërive pensionore dhe miratime për menaxhim me fonde pensionore të obligueshme dhe/ose vullnetare;
- kryen supervizim të punës së shoqërive pensionore dhe të fondeve pensionore me të cilat ato menaxhojnë, si dhe të ruajtësve të mjeteve të fondeve pensionore dhe të menaxherëve të huaj të mjeteve;
- promovon, organizon dhe nxit zhvillimin e sigurimit pensionor të financuar me kapital në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në bashkëpunim me Ministrinë e politikës sociale, demografisë dhe të rinjve dhe të zhvillojë vetëdijen e publikut për qëllimet dhe parimet e shoqërive pensionore dhe të fondeve pensionore dhe
- sjell akte sipas këtij ligji dhe sipas Ligjit për sigurim pensionor vullnetar të financuar me kapital, si dhe udhëzime profesionale, doracakë e të ngjashme, lidhur me sigurimin pensionor të financuar me kapital dhe nismon sjelljen e rregulloreve dhe akteve tjera lidhur me shoqëritë pensionore dhe me fondet pensionore me të cilat ato menaxhojnë.

Në vitin 2025, Agjencia u kujdes për të drejtat dhe interesat e 630.396 anëtarëve të fondeve private pensionore të obligueshme dhe për 35.944 anëtarëve të fondeve private pensionore vullnetare me vlerë totale të mjeteve në të gjitha fondet prej mbi 3,14 miliardë euro. Agjencia vazhdoi ta përsosë funksionin e saj përmes intensifikimit të kontrollit në terren dhe jashtë terrenit të shoqërive pensionore dhe të fondeve pensionore.

Kontrolli jashtë-terrenit i punës së shoqërive pensionore, fondeve pensionore të obligueshme dhe fondeve pensionore vullnetare bëhej vazhdimisht, në bazë të raporteve dhe informacioneve të dorëzuara nga shoqëritë pensionore dhe nga institucionet tjera të përfshira në sistem, siç janë:

Fondi i sigurimit pensionor dhe invalidor i Maqedonisë së Veriut dhe ruajtësit e pasurisë së fondeve pensionore.

Në tremujorin e parë, të tretë dhe të katërt të vitit 2025, u krye kontroll i rregullt në terren i punës së tre shoqërive pensionore dhe menaxhimit të tyre me mjetet e fondeve pensionore të obligueshme dhe vullnetare dhe një shoqërie pensionore e cila menaxhon me fond pensionor vullnetar (kontroll institucional dhe financiar), sipas „Planit vjetor të Agjencisë për kontrollin e punës së shoqërive pensionore“ për vitin 2025. Kontrolli u zbatua në bazë të vlerësimit të rreziqeve, drejtpërdrejt, me prani në ambientet e shoqërive pensionore dhe ruajtësit të pasurisë.

Agjencia nismon propozime për ndryshimin e Ligjit për sigurim pensionor të obligueshëm të financuar me kapital deri te Ministria e politikës sociale, demografisë dhe të rinjve dhe në mënyrë aktive jepte kontribut në propozimet, të dhëna nga Ministria, për ndryshimin e Ligjit për sigurim pensionor të obligueshëm të financuar me kapital, Ligjit për sigurim pensionor vullnetar të financuar me kapital dhe Ligjit për pagesën e pensioneve dhe kompensimeve pensionore nga sigurimi pensionor i financuar me kapital. Gjithashtu, në vitin 2025 Agjencia përpiloi dhe solli akte nënligjore (rregullore dhe vendime) dhe udhëzime teknike të cilat kanë të bëjnë me sigurimin pensionor të obligueshëm dhe vullnetar të financuar me kapital dhe punën e Agjencisë.


Agjencia, si anëtare e Organizatës ndërkombëtare të supervizorëve pensionorë (IOPS), mori pjesë në mënyrë aktive në punën e saj duke u përcaktuar për ndjekjen e parimeve në kryerjen e funksionit të saj rregullator dhe supervizor, të ndërtuara në bazë të praktikave më të mira botërore. Agjencia rregullisht i ndjek ndryshimet dhe plotësimet e së drejtës së Bashkimit Evropian (acquis of EU) dhe në vitin 2025 mori pjesë në mënyrë aktive në përpilimin e Programit kombëtar për miratimin e së drejtës së Bashkimit Evropian, Raportin për përparimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Programin për reforma ekonomike të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga aspekti i sigurimit pensionor me financim kapital.

1 Organizimi dhe financimi i Agjencisë për mbikqyrjen e financimit kapital të sigurimit pensional

1.1 Skema organizative e Agjencisë

Deri më 31.12.2025, Agjencia kishte gjithsej 33 të punësuar, prej të cilëve tre anëtarë të Këshillit të ekspertëve të emëruar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe 30 nëpunës administrativë. Nga numri i përgjithshëm i nëpunësve administrativë 26 janë me arsim të lartë profesional, ndërsa 4 janë me arsim të mesëm profesional. Nga nëpunësit administrativë me arsim të lartë një është doktor i shkencave dhe gjashtë janë magjistër, një është aktuara, një është revizor i brendshëm në sektorin publik, tre janë këshilltarë investues dhe katër kanë të dhënë provimin e jurisprudencës. Skema organizative e Agjencisë

[Grafiku i skemës organizative]



1.2 Puna e Këshillit të ekspertëve të Agjencisë

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut në seancën e mbajtur më 14.05.2025 solli vendim për shkarkimin e kryetarit ekzistues Maksud Ali dhe emërimin e Remzi Bajramit për kryetar të ri të Këshillit të ekspertëve të Agjencisë. Anëtarët tjerë të Këshillit të ekspertëve janë Mentor Jakupi dhe Darko Sazdov si anëtarë të angazhuar në mënyrë profesionale të Këshillit të ekspertëve të Agjencisë dhe Borçe Bozhinoski dhe Marina Makenaxhieva si anëtarë të jashtëm të Këshillit të ekspertëve të Agjencisë. Në seancën e mbajtur më 16.12.2025 Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut me vendim emëroi Pranvera Ajazin si anëtare të angazhuar në mënyrë profesionale të Këshillit të ekspertëve në vend të anëtarit Mentor Jakupi të cilit i pushoi mandati për shkak të përmbushjes së kushteve ligjore.

Gjatë vitit 2025 Këshilli i ekspertëve të Agjencisë, sipas të drejtave dhe obligimeve të tij të përfshira në Ligjin për sigurim pensionor të obligueshëm të financuar me kapital, Statutin e Agjencisë dhe Rregulloren e punës së Këshillit të ekspertëve, rregullisht mbante seanca në të cilat diskutonte dhe vendoste për çështje nga kompetenca e tij. Këshilli i ekspertëve në vitin 2025 mbajti gjithsej 15 seanca në të cilat:

a) Miratoi:

- Raport për gjendjet në sigurimin pensionor të financuar me kapital në vitin 2024;
- Raport vjetor për punën e Agjencisë për mbikqyrjen e financimit kapital të sigurimit pensional në vitin 2024;
- Raport për realizimin e Planit vjetor për punësim të Agjencisë për mbikqyrjen e financimit kapital të sigurimit pensional për periudhën janar – qershor 2025;
- Raport për realizimin e Planit vjetor për punësim të Agjencisë për mbikqyrjen e financimit kapital të sigurimit pensional për periudhën korrik – dhjetor 2025;
- Raport vjetor për masat e shqiptuara për përgjegjësi të konstatuar disiplinore dhe materiale për vitin 2025 dhe
- Raport me listën e renditjes së vlerësimeve vjetore të nëpunësve administrativë në Agjencinë për mbikqyrjen e financimit kapital të sigurimit pensional për vitin 2025.

b) Shqyrtoi:

- Vendim të sjellë nga ana e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për shkarkimin e Maksud Ali nga detyra kryetar i Këshillit të ekspertëve dhe emërimin e Remzi Bajramit për kryetar të Këshillit të ekspertëve të Agjencisë për mbikqyrjen e financimit kapital të sigurimit pensional;

- Vendim të sjellë nga ana e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për emërimin e Pranvera Suma si anëtare e angazhuar në mënyrë profesionale e Këshillit të ekspertëve të Agjencisë për mbikqyrjen e financimit kapital të sigurimit pensional;
- Raport tremujor për realizimin e Planit vjetor për prokurime publike për periudhën nga 01.01.2025 deri më 31.03.2025;
- Raport tremujor për realizimin e Planit vjetor për prokurime publike për periudhën nga 01.04.2025 deri më 30.06.2025;
- Raport tremujor për realizimin e Planit vjetor për prokurime publike për periudhën nga 01.07.2025 deri më 30.09.2025;
- Raport financiar tremujor për periudhën nga 01.10.2024 deri më 31.12.2024;
- Raport financiar tremujor për periudhën nga 01.01.2025 deri më 31.03.2025;
- Raport financiar tremujor për periudhën nga 01.04.2025 deri më 30.06.2025;
- Raport financiar tremujor për periudhën nga 01.07.2025 deri më 30.09.2025;
- Raport gjashtëmujor për realizimin e planit financiar të Agjencisë për mbikqyrjen e financimit kapital të sigurimit pensional në vitin 2024 për periudhën nga 01.07.2024 deri më 31.12.2024;
- Raport gjashtëmujor për realizimin e planit financiar të Agjencisë për mbikqyrjen e financimit kapital të sigurimit pensional në vitin 2025 për periudhën nga 01.01.2025 deri më 30.06.2025;
- Raporte financiare për vitin 2024 me Raport të revizorit të pavarur të jashtëm; • Raport përfundimtar nga Revizori i brendshëm i Agjencisë për mbikqyrjen e financimit kapital të sigurimit pensional për revizion të kryer të procesit për licencim dhe miratim;
- Raport përfundimtar nga Revizori i brendshëm i Agjencisë për mbikqyrjen e financimit kapital të sigurimit pensional për revizion të menaxhimit me rreziqet e Agjencisë për mbikqyrjen e financimit kapital të sigurimit pensional;
- Raport përfundimtar nga Revizori i brendshëm i Agjencisë për mbikqyrjen e financimit kapital të sigurimit pensional për revizion të procesit për prokurime publike të Agjencisë për mbikqyrjen e financimit kapital të sigurimit pensional;
- Raport përfundimtar nga Revizori i brendshëm i Agjencisë për mbikqyrjen e financimit kapital të sigurimit pensional për revizion të kryer të aktiviteteve jashtë-terrenit në departamentin për kontroll financiar;

- Raport gjashtëmuor për punën e Komisionit për vendosje mbi kundërvajtje të Agjencisë për mbikqyrjen e financimit kapital të sigurimit pensional për periudhën janar – qershor 2025;

- Raport gjashtëmuor për punën e Komisionit për vendosje mbi kundërvajtje të Agjencisë për mbikqyrjen e financimit kapital të sigurimit pensional për periudhën korrik – dhjetor 2025;

- Raport për aktivitetet e Komitetit për vlerësimin e rreziqeve në vitin 2024; • Raport për kënaqësinë e të punësuarve nga puna në Agjencinë për mbikqyrjen e financimit kapital të sigurimit pensional në periudhën 2023-2024;

- Raport për video mbikëqyrje për vitin 2023-2025;

c) Solli:

- Plan vjetor për prokurime publike në vitin 2025 të Agjencisë për mbikqyrjen e financimit kapital të sigurimit pensional;

- Ndryshimin e parë të Planit vjetor për prokurime publike në vitin 2025 të Agjencisë për mbikqyrjen e financimit kapital të sigurimit pensional;

- Programin vjetor për punë të Agjencisë për mbikqyrjen e financimit kapital të sigurimit pensional për vitin 2025 me Plan aksionar për zbatimin e Programit vjetor;

- Ndryshim të Planit vjetor të Agjencisë për mbikqyrjen e financimit kapital të sigurimit pensional për kontroll në terren për vitin 2025;

- Plan financiar të Agjencisë për mbikqyrjen e financimit kapital të sigurimit pensional për vitin 2026;

- Raporte financiare për vitin 2024 të Agjencisë për mbikqyrjen e financimit kapital të sigurimit pensional;

- Plan vjetor të Agjencisë për mbikqyrjen e financimit kapital të sigurimit pensional për kontroll në terren për vitin 2026;

- Plan vjetor për punësim të Agjencisë për mbikqyrjen e financimit kapital të sigurimit pensional për vitin 2026;

- 13 rregullore;

- 11 vendime dhe

- 26 zgjidhje.

ç) Dha pëlqim/miratim për:

- Planin strategjik për ekzekutimin e revizionit të brendshëm në Agjencinë për mbikqyrjen e financimit kapital të sigurimit pensional për periudhë prej tre viteve nga viti 2026 deri në vitin 2028;
- Planin vjetor për ekzekutimin e revizionit të brendshëm në Agjencinë për mbikqyrjen e financimit kapital të sigurimit pensional për vitin 2026;
- 20 kërkesa nga shoqëritë pensionore të cilat kanë të bëjnë me miratimin e ndryshimit të statutit të fondit pensionor, miratim për zgjedhjen e personave me autorizime të veçanta dhe përgjegjësi në shoqërinë pensionore, anëtarë të bordit menaxhues dhe mbikëqyrës, etj.

d) Ka kryer:

- Vlerësimin e të punësuarve në Agjencinë për mbikqyrjen e financimit kapital të sigurimit pensional për vitin 2025 sipas Ligjit për nëpunës administrativë dhe Kontratës kolektive të Agjencisë.

dh) Vendosi:

- Të lidhet Aneks ndaj Kontratës kolektive të Agjencisë për mbikqyrjen e financimit kapital të sigurimit pensional.

1.3 Financimi i Agjencisë

Puna e Agjencisë, sipas Ligjit për sigurim pensionor të obligueshëm të financuar me kapital, financohet nga kompensimet të cilat Agjencia i arkëton nga shoqëritë pensionore.

Në Ligjin për sigurim pensionor të obligueshëm të financuar me kapital është përshkruar se lartësinë e kompensimeve të cekura e përcakton Këshilli i ekspertëve i Agjencisë, për të cilat pëlqim jep Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe ato publikohen në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“.

Gjatë vitit 2025 Agjencia llogariti kompensimin nga kontributet e paguara në të gjitha fondet pensionore me të cilat menaxhojnë shoqëritë pensionore në bazë të shkallës së përcaktuar në vendimin e sjellë nga Agjencia më 25.09.2024. Për lartësinë e kompensimit për vitin 2025 ishin përpiluar analiza të anës së shpenzimeve dhe të hyrave nga financimi i Agjencisë. Për anën e shpenzimeve ishin përdorur shpenzimet e parashikuara të Agjencisë sipas Planit financiar të Agjencisë për vitin 2025 dhe Programit për punë për vitin 2025, ndërsa për anën e të hyrave ishin përpiluar analiza në bazë të projeksioneve të prurjeve të kontributeve në fondet pensionore të obligueshme dhe vullnetare (të cilat janë bazë për llogaritjen e kompensimit).

Për prurjen e pritur të kontributeve në vitin 2025 ishin përdorur vlerësime për prurje të kontributeve në fondet pensionore të obligueshme dhe vullnetare. Për prurjen e kontributeve në shtyllën e dytë ishin përdorur projeksionet buxhetore për shpenzime tranzicioni të Fondit të SPIM, ndërsa për prurjen e kontributeve në shtyllën e tretë ishin përdorur të dhënat reale nga prurjet në vitin 2024 dhe vlerësime për vitin 2025.

Përmes llogaritjes së raportit midis shpenzimeve të planifikuara për vitin 2025 dhe kontributeve të projektuara dhe duke i marrë parasysh kursimet nga vitet paraprake, është përfituar lartësia e kompensimit nga kontributet prej 0,6%.

2 Aktivitetet e realizuara në periudhën raportuese

2.1 Supervizimi i shoqërive pensionore dhe fondeve pensionore

2.1.1 Supervizimi jashtë-terrenit

Në vitin 2025 u krye kontroll i vazhdueshëm jashtë-terrenit i punës së shoqërive pensionore, fondeve pensionore të obligueshme dhe fondeve pensionore vullnetare në bazë të raporteve dhe informacioneve të dorëzuara nga shoqëritë pensionore dhe institucionet tjera të përfshira në sistem, siç janë Fondi i SPIM dhe ruajtësit e pasurisë së fondeve pensionore.

Objekt i kontrollit të punës së shoqërive pensionore ishin fushat në vijim:

- proceset e marketingut të shoqërive pensionore kontroll i materialeve të publikuara të marketingut, kontroll i faqeve të internetit të shoqërive pensionore, kontroll i publikimeve të obligueshme, si dhe të aktiviteteve të shoqërive pensionore lidhur me punë nga marketingu. Agjencia kreu kontrole dhe veprimi në gjithsej 454 lëndë të cilat kanë të bëjnë me punë nga fusha e marketingut të shoqërive pensionore;
- anëtarësimi në fondet pensionore mënyra e lidhjes së kontratave për anëtarësim, veprimi sipas parashtrësive për shkëputjen e kontratave për anëtarësim në fondin pensionor të obligueshëm dhe kontroll i punës së agjentëve të shoqërive;
- kontroll i rregullt i agjentëve gjithsej 33 agjentë dhe kontroll shtesë i agjentëve gjithsej 2 agjentë me kontroll të detajuar të të gjitha kontratave për anëtarësim për agjentët;
- kontabiliteti dhe raportet financiare të shoqërive pensionore, shuma minimale e mjeteve likuide, mjeteve vetjake dhe kryegjësë të cilat duhet t'i mirëmbajnë shoqëritë pensionore, treguesit financiarë dhe trendet. Gjatë kontrolleve u konstatua se shoqëritë pensionore vazhdimisht i përmbushnin kushtet për mjete likuide, për mjete vetjake dhe për kryegjë.

Sipas Ligjit për sigurim pensionor të obligueshëm të financuar me kapital dhe Ligjit për sigurim pensionor vullnetar të financuar me kapital, shoqëritë pensionore janë të obliguara të formojnë njësi për revizion të brendshëm. Njësitë për revizion të brendshëm përpilojnë raporte për kontrollet e kryera dhe janë të obliguara të njëjtat t'i dorëzojnë deri te Agjencia, me ç'rast, Agjencia e ndjek punën e shoqërive përmes raporteve të dorëzuara dhe i lokon rreziqet e

mundshme në punën e shoqërive. Në vitin 2025 Agjencia ishte e njoftuar për 17 revizione të rregullta të brendshme të realizuara.

Sipas Rregullores për mënyrën e parandalimit të keqpërdorimit të informacioneve të fituara si rezultat i pozitës zyrtare dhe për përmbajtjen dhe mënyrën e njoftimit për transaksione me letra me vlerë, si pjesë e kontrolleve të rregullta jashtë-terrenit, Agjencia kreu kontroll të të dhënave të dorëzuara nga shoqëritë dhe nga ruajtësit e pasurisë për transaksionet me letra me vlerë të personave me qasje në informacione konfidenciale dhe personave të tyre të lidhur dhe të transaksioneve të shoqërive pensionore. Shoqëritë dhe ruajtësit e pasurisë dorëzojnë deri te Agjencia të dhëna për transaksione të lidhura në çdo 180 ditë. Gjatë kontrollit të të dhënave për transaksionet e lidhura me letra me vlerë të personave me qasje në informacione konfidenciale dhe personave të tyre të lidhur, Agjencia konstaton se nuk ka transaksione të dyshimta.

Agjencia i kontrollonte edhe transaksionet me letra me vlerë të personave të punësuar në Agjenci me qasje në informacione konfidenciale dhe me atë rast konstatoi se nuk ka transaksione të dyshimta me letra me vlerë nga ana e të punësuarve në Agjenci.

Objekt i kontrollit të punës së fondeve pensionore nga ana e Agjencisë ishin fushat në vijim:

- shpërndarja e kontributeve në llogaritë individuale të anëtarëve në fondet pensionore të obligueshme; • kompensimet të cilat i arkëtojnë shoqëritë pensionore nga kontributet dhe menaxhimi me mjete;
- aktivitetet investuese për: kufizime cilësore dhe sasiore lidhur me investimet në instrumente financiare, sipas Rregullores për investim të mjeteve të fondeve pensionore të obligueshme dhe Rregullores për investim të mjeteve të fondeve pensionore vullnetare; • transaksione të lidhura nga ana e shoqërisë nga aspekti i çmimit, sasisë, tregut në të cilin është lidhur transaksioni, ndërmjetësit, provizionit ndërmjetësues për transaksionet e lidhura gjatë vitit, për fondet pensionore të obligueshme dhe vullnetare;
- përmbushja e kriterëve cilësore dhe sasiore dhe të kufizimeve ligjore sipas klasave të instrumenteve, për instrumentet të cilat janë tashmë në portofolet e fondeve pensionore;
- vlerësimi i vlerës së mjeteve dhe obligimeve të fondeve pensionore të obligueshme dhe vullnetare për gjendjen e tyre në fund të ditës së mëparshme të punës;
- llogaritja e vlerës së njësisë kontabël, numrit të njësive kontabël dhe të vlerës së mjeteve neto të fondeve pensionore të obligueshme dhe vullnetare, për gjendjen në fund të ditës së mëparshme të punës. Agjencia, në data të caktuara të vlerësimit i kontrollon vlerën e njësive kontabël, numrin e njësive kontabël dhe vlerën e mjeteve neto të fondeve pensionore të obligueshme, të dorëzuara nga shoqëritë pensionore dhe bankat ruajtëse të pasurisë. Në faqen e saj të internetit, Agjencia e publikon vlerën e njësive kontabël dhe vlerën e mjeteve neto për çdo fond pensionor të obligueshëm dhe vullnetar;

- transferimi i mjeteve midis fondeve pensionore të obligueshme, transferim nga llogari e veçantë në llogari individuale, kalim nga njëri në tjetrin fond pensionor ose në Fondin e SPIM, për shkak të shkëputjes së kontratës për anëtarësim;
- pagesa nga fondet pensionore të obligueshme deri te Fondi i SPIM në bazë të pensionit invalidor ose familjar dhe kontroll i pagesave në bazë të trashëgimisë;
- pagesa deri te anëtarët dhe anëtarët e pensionuar të fondeve pensionore të obligueshme dhe vullnetare sipas Ligjit për pagesën e pensioneve dhe kompensimeve pensionore nga sigurimi pensionor i financuar me kapital;
- kontabiliteti dhe raporteve financiare të fondeve pensionore të obligueshme dhe vullnetare përmes kontrollit në bazë tremujore;
- raportet për strategjinë dhe taktikën investuese të fondeve pensionore të obligueshme dhe vullnetare përmes kontrollit gjatë çdo dorëzimi dhe ndjekje aktuale e realizimit të saj; • raportet e dorëzuara nga ruajtësit e pasurisë së fondeve pensionore të obligueshme dhe vullnetare siç janë: raporte për llogari, raporte për transaksione të lidhura dhe të përlllogaritura, portofolet e fondeve pensionore të obligueshme dhe vullnetare, raporte për akordime investuese, si dhe raporte për transferim midis fondeve dhe pagesa nga fondet pensionore;
- raportet e dorëzuara nga menaxheri me rreziqe, aktuara dhe revizori i brendshëm dhe i jashtëm në shoqëritë pensionore që i mbulojnë fushat e punës së fondeve pensionore.

Gjatë kontrolleve të përditshme të punës së shoqërive pensionore dhe ruajtësve të pasurisë u vërejtën gabime dhe parregullsi të caktuara gjatë raportimit, për të cilat Agjencia, përmes kontrollit proaktiv, u tregoi shoqërive dhe ruajtësve të pasurisë me qëllim përmirësimin e proceseve të biznesit, për të cilat menjëherë u veprua nga ana e shoqërive pensionore dhe ruajtësve të pasurisë. Me atë rast, është shqiptuar një Vërejtje ndaj ruajtësit të pasurisë dhe një Drejtim ndaj shoqërisë pensionore.

2.1.2 Kontrolli në terren i shoqërive pensionore dhe fondeve pensionore

Sipas Planit vjetor të Agjencisë për kontrollin e punës së shoqërive pensionore dhe ruajtësve të pasurisë për vitin 2025, në tremujorin e parë, të tretë dhe të katërt të vitit 2025, u krye nga një kontroll i rregullt i KB Shoqëria e parë pensionore SHA Shkup, Sava shoqëria pensionore SHA Shkup, Trigllav Shoqëria pensionore SHA Shkup dhe VFP Shoqëria pensionore SHA Shkup për punën e shoqërive pensionore dhe menaxhimit të tyre me mjetet e fondeve pensionore të obligueshme / vullnetare (kontroll institucional dhe financiar), në bazë të vlerësimit të rreziqeve dhe akordimit me rregulloret.

Kontrolli në terren i shoqërive pensionore i përfshin aspektet në vijim të punës së tyre:

- Cilësia dhe struktura e menaxhmentit;
- Strategjia e shoqërisë dhe fondeve;

- Kontrolllet interne; • Menaxhimi me rreziqe dhe
- Marrja e vendimeve.

Në vitin 2025 është zbatuar kontroll te ruajtësi i pasurisë Komercialna Banka SHA Shkup. Kontrolli në terren i ruajtësit të pasurisë i përfshin aspektet në vijim të punës së tij:

- Organizimi dhe vendosja teknike e ruajtësit të pasurisë;
- Llogaritjet e mjeteve neto dhe njësisë kontabël të fondeve pensionore;
- Ruajtja dhe evidenca e mjeteve të fondeve pensionore;
- Ndjekja e kufizimeve gjatë investimit të mjeteve të fondeve pensionore dhe akordimi i tyre me ligjet dhe rregulloret nënligjore dhe
- Veprimi sipas rekomandimeve nga kontrolli i mëparshëm në terren;

Në bazë të konstatimeve dhe vërejtjeve nga kontrolli i kryer i shoqërive pensionore dhe ruajtësit të pasurisë, dhe duke i marrë parasysh zakonet dhe praktikat e mira të biznesit, si dhe nevojën për përmirësim të vazhdueshëm të punës së shoqërive me qëllim avancimin dhe zhvillimin e sigurimit pensionor të financuar me kapital dhe mbrojtjen e interesave të anëtarëve të fondeve pensionore, Agjencia shqiptoi 15 Drejtime, 17 Rekomandime dhe 2 Vërejtje ndaj shoqërive pensionore. Ndaj ruajtësit të pasurisë shqiptoi 1 Rekomandim.

Rekomandimet dhe drejtimit e Agjencisë janë në drejtim të përmirësimit të punës së shoqërive dhe ruajtësit të pasurisë.

Shoqëritë dhe ruajtësi i pasurisë të cilët sipas procedurës marrin procesverbal nga kontrolli në terren, dorëzuan Plan aksionar deri te Agjencia me të cilin njoftuan se i pranojnë masat e Agjencisë dhe do të veprojnë sipas tyre në përputhje me Planin e dorëzuar aksionar.

2.1.3 Komiteti për vlerësimin e rreziqeve

Komiteti për vlerësimin e rreziqeve pranë Agjencisë (KVR) i kryen punët në vijim:

- I shqyrton dhe i përcakton rreziqet në sigurimin pensionor të financuar me kapital në dokumentin „Analiza e rreziqeve në sigurimin pensionor të financuar me kapital“;
- I shqyrton Analizat e ndryshoreve bazë në sigurimin pensionor të financuar me kapital për periudhë prej 5 viteve;
- I shqyrton raportet e nënshkruara dhe procesverbalet nga kontrolli për shkak të pasqyrimit në vlerësimet e rreziqeve të subjektet individuale të kontrollit dhe jep drejtime për vlerësimet e mëtejshme të rreziqeve;

- I shqyrton zhvillimet më të reja në sigurimin pensionor të financuar me kapital ose në tregjet financiare, të cilat mund të ndikojnë mbi vlerësimet e rreziqeve;
- Përcakton rreziqe të reja të sigurimit pensionor të financuar me kapital dhe/ose i ripërcakton rreziqet ekzistuese dhe përcakton ekip për vlerësimin e rreziqeve;
- Jep propozime për nismimin ose rishikimin e strategjive për zbutjen e rreziqeve;
- E shqyrton efektivitetin e strategjive për zbutjen e rreziqeve dhe në bazë të asaj, propozon ndryshime të strategjisë dhe të planit vjetor të Agjencisë;
- Identifikon dhe propozon ndryshime të rregulloreve në drejtim të zbutjes së rreziqeve;
- Mban llogari, të punësuarit në Agjenci të jenë mjaftueshëm të vetëdijshëm dhe të kenë mjaftueshëm njohuri për rreziqet dhe për kontrollin në bazë të vlerësimit të rreziqeve me qëllim që të mund t'i kryejnë detyrat e tyre të punës dhe
- Mban llogari, të gjithë pjesëmarrësit në kontroll, në bazë të vlerësimit të rreziqeve, të jenë mjaftueshëm të vetëdijshëm për aspektet kyçe të kontrollit me qëllim që të bashkëpunojnë dhe t'i japin mbështetje Agjencisë në drejtimin e burimeve të saj.

Gjatë vitit 2025, Komiteti për vlerësimin e rreziqeve mbajti 4 takime në të cilat u shqyrtuan:

- Propozim-plani për zbatimin e kontrolleve në terren në vitin 2026,
- Gjetjet nga kontrollet e zbatuara në terren në shoqëritë pensionore,
- Investimi i mjeteve të fondeve pensionore,
- Rreziqet në sigurimin pensionor të financuar me kapital, duke i përfshirë raportet për menaxhim me rreziqet e fondeve pensionore,
- Shpërndarja e kontributeve në shtyllën e dytë dhe gjendjet aktuale me transferet nga Fondi i SPIM,
- Raportet për punë financiare të shoqërive pensionore,
- Gjetje nga revizionet e brendshme,
- Analiza e ankesave,
- Analiza e ndryshoreve bazë në sigurimin pensionor të financuar me kapital,
- Strategjia për masa makropruidente dhe obligimet që dalin nga strategjia për masa makropruidente,

- Analiza të të dhënave përmes aplikacionit Business Intelligence Tool - Metabase.

3 Funkzioni rregullator dhe procedurat

Gjatë vitit 2025-të u sollën dy ndryshime të Ligjit për sigurim pensionor të obligueshëm të financuar me kapital dhe u publikuan në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“ numër 86/2025 dhe 114/2025. Akte nënligjore Në vitin 2025 Agjencia përpiloi dhe solli akte nënligjore (rregullore dhe vendime) dhe udhëzime teknike të cilat kanë të bëjnë me sigurimin pensionor të obligueshëm dhe vullnetar të financuar me kapital dhe punën e Agjencisë dhe atë:

a) rregullore:

1. Rregullore për ndryshim dhe plotësim të rregullores për formën dhe përmbajtjen e raporteve financiare të shoqërisë pensionore („Gazeta Zyrtare e RMV“ nr. 196/2025);
2. Rregullore për kushtet më të afërta për themelimin e shoqërive pensionore („Gazeta Zyrtare e RMV“ nr. 196/2025);
3. Rregullore për ndryshim të plotësimin të Rregullores për mënyrën dhe procedurën e marketingut të fondeve pensionore („Gazeta Zyrtare e RMV“ nr. 142/2025);
4. Rregullore për investim të mjeteve të fondeve pensionore („Gazeta Zyrtare e RMV“ nr. 142/2025);
5. Rregullore për ndërprerje të vlefshmërisë së Rregullores për mënyrën e shkatërrimit të dokumenteve dhe mënyrën e shkatërrimit, fshirjes dhe pastrimit të mediumit në Agjencinë për mbikqyrjen e financimit kapital të sigurimit pensional dhe rregulloren për masat teknike dhe organizative për sigurimin e fshehtësisë dhe mbrojtjen e përpunimit të të dhënave personale („Gazeta Zyrtare e RMV“ nr. 118/2025);
6. Rregullore për ndryshim të Rregullores për vlerësimin e mjeteve të fondeve pensionore të obligueshme dhe vullnetare („Gazeta Zyrtare e RMV“ nr. 51/2025);

3.1 Miratimet dhe pëlqimet Në vitin 2025

Agjencia i zbatoi procedurat në vijim për dhënien e miratimeve dhe pëlqimeve sipas kërkesave nga shoqëritë pensionore, në bazë të Ligjit për sigurim pensionor të obligueshëm të financuar me kapital dhe Ligjit për sigurim pensionor vullnetar të financuar me kapital, dhe i solli zgjidhjet në vijim:

1. Zgjidhje për miratim për caktimin e Aleksandar Petrov për person përgjegjës për llogaritjen e tërheqjeve të programuara të TRIGLLAV SHOQËRIA PENSIONORE SHA Shkup
2. Zgjidhje për ndryshim dhe/ose plotësim të statutit të VFP SHOQËRIA PENSIONORE SHA SHKUP
3. Zgjidhje për miratim për rizgjedhjen e Vesna Stojanovska për anëtare e Bordit menaxhues të KB Shoqëria e parë pensionore SHA Shkup.

4. Zgjidhje për miratim për ndryshim të Statutit të Trigllav fondi i hapur vullnetar pensionor - Shkup,
5. Zgjidhje për dhënien e pëlqimit të Sava shoqëria pensionore sh.a. Shkup për lidhjen e kontratave për ndërmjetësim gjatë shitblerjes së letrave me vlerë.
6. Zgjidhje për dhënien e pëlqimit të VFP shoqëria pensionore SHA Shkup për fitimin e aksioneve nga emisioni IV (i katërt) përmes ofertës private.
7. Zgjidhje për miratim për ndryshim dhe/ose plotësim të Statutit të VFP shoqëria pensionore SHA Shkup.
8. Zgjidhje për miratim për zgjedhjen e Rok Papiç për anëtar të pavarur të Bordit mbikëqyrës të KB Shoqëria e parë pensionore SHA Shkup.
9. Zgjidhje për miratim për rizgjedhjen e Maja Stevkova Shterieva për anëtare të Bordit mbikëqyrës të KB Shoqëria e parë pensionore SHA Shkup.
10. Zgjidhje për dhënien e pëlqimit të kontratave të lidhura për kryerjen e punëve të ndërmjetësit bursor të KB Shoqëria e parë pensionore SHA Shkup.
11. Zgjidhje për dhënien e pëlqimit të kontratave të lidhura midis Trigllav shoqëria pensionore SHA Shkup dhe personave juridikë të cilët kryejnë shërbime me letra me vlerë.
12. Zgjidhje për miratim për ndryshim dhe/ose plotësim të Statutit të fondit pensionor të VFP shoqëria pensionore SHA Shkup.
13. Zgjidhje për miratim për caktimin e Boro Antovski për person përgjegjës për revizion të brendshëm në Trigllav shoqëria pensionore SHA Shkup.
14. Zgjidhje për miratim për zgjedhjen e Silvana Mojsovska për anëtare të pavarur të Bordit mbikëqyrës të Sava shoqëria pensionore sh.a. Shkup.
15. Zgjidhje për miratim për caktimin e Bobana Dimeska për person përgjegjës për marketing në Trigllav shoqëria pensionore SHA Shkup.
16. Zgjidhje për dhënien e pëlqimit të kontratave të lidhura me persona juridikë vendorë për kryerjen e shërbimeve me letra me vlerë të VFP shoqëria pensionore SHA Shkup.
17. Zgjidhje për miratim për rizgjedhjen e Rok Pivk për anëtar të Bordit mbikëqyrës të Trigllav shoqëria pensionore SHA Shkup.
18. Zgjidhje për miratim për caktimin e Aleksandar Smilkovski për person përgjegjës për menaxhim me llogari individuale në Trigllav shoqëria pensionore SHA Shkup.
19. Zgjidhje për miratim për caktimin e Sunçica Neshovska për person përgjegjës për marketing në Trigllav shoqëria pensionore SHA Shkup.

3.2 Komisioni për vendosje mbi kundërvajtje

Gjatë vitit 2025 para Komisionit për vendosje mbi kundërvajtje nuk janë iniciuar procedura për kundërvajtje.

4 Veprimet lidhur me të drejtat e anëtarëve, ankesat dhe propozimet

4.1 Njoftimi i personave të shpërndarë përgjithmonë dhe përkohësisht në fondin pensionor të obligueshëm

Në vitin 2025, sipas nenit 8 paragrafi (5) nga Rregullorja për anëtarësim në fondin pensionor të obligueshëm, Agjencia dërgoi gjithsej 8.218 njoftime me shkrim deri te personat të cilët

janë të shpërndarë përkohësisht në fondin pensionor të obligueshëm. Sipas kontratave për dhënien e të dhënave personale, të lidhura me Ministrinë e punëve të brendshme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe shoqëritë pensionore, Agjencia siguroi dhe dorëzoi 62.467 të dhëna kontakti nga anëtarët e shpërndarë përgjithmonë (të dhënë për adresën e kontaktit) deri te tre shoqëritë pensionore. 19

4.2 Veprimet sipas kërkesave Agjencia veproi sipas kërkesave nga: të siguruarit, anëtarët e fondeve pensionore të obligueshme dhe shoqëritë pensionore dhe propozonte deri te kryetari i Këshillit të ekspertëve të Agjencisë marrjen e aktiviteteve dhe masave konkrete.

Në vitin 2025, nga njëri në tjetrin fond pensionor të obligueshëm, kaluan gjithsej 12.658 anëtarë dhe atë: në Trigllav shoqëria pensionore SHA Shkup 7.112 anëtarë, në KB Fondi i parë i hapur pensionor i obligueshëm 3.539 anëtarë, ndërsa në Fondin e hapur pensionor të obligueshëm Sava fondi pensionor 2.007 anëtarë.

4.3 Veprimet sipas ankesave dhe propozimeve

Sipas Ligjit për sigurim pensionor të obligueshëm të financuar me kapital anëtarëve të cilët kanë stazh të beneficuar u jepet mundësi për dorëzimin e Deklaratës për vazhdimin e anëtarësimin në fondin pensionor të obligueshëm kur do të mbushin stazh të sigurimit që mundëson zvogëlimin e kufirit të moshës për realizimin e së drejtës së pensionit pleqëror për të paktën një vit. Afati për dorëzimin e Deklaratës ishte deri më 16.09.2025. Të drejtë të dorëzojnë Deklaratë kishin 994 persona, prej tyre 42 persona vendosën ta vazhdojnë anëtarësimin në fondin pensionor të obligueshëm. Pas skadimit të afatit, më 16.09.2025, 952 anëtarëve të cilët nuk dorëzuan Deklaratë u pushoi anëtarësimi në fondet pensionore të obligueshme.

Gjatë vitit 2025, deri te Agjencia, arritën 123 njoftime për kërkesë të dorëzuar për pagesë trashëgimtari të cilave Agjencia u përgjigj pozitivisht.

5 Aktivitetet lidhur me agjentët e shoqërive pensionore

Në vitin 2025, Agjencia organizoi pesë sesione provimi (në korrik, shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor). Provimi përbëhet nga dhënia e dy pjesëve, pjesa e parë (teorike) e provimit me të cilën kontrollohet njohuria teorike e kandidatit dhe pjesa e dytë (praktike) e provimit me të cilën kontrollohet aftësia praktike e kandidatit. Pjesa e parë dhe e dytë e provimit jepeshin në mënyrë elektronike, sipas Programit për dhënien e provimit për agjentë të cilin e përpilon Agjencia. Konsiderohet se kandidati e dha pjesën e parë përkatësisht pjesën e dytë të provimit nëse ka fituar të paktën 70% nga numri i përgjithshëm i pikëve pozitive të parashikuara për pjesën e parë përkatësisht për pjesën e dytë të provimit. Kandidati i cili nuk e dha pjesën e parë të provimit nuk mund ta japë pjesën e dytë. Nëse kandidati nuk e ka dhënë as pjesën e dytë të provimit, do të konsiderohet se nuk e ka dhënë provimin.

Gjatë vitit 2025 Agjencia vazhdoi rregullisht t'i shfletojë ndryshimet e ligjeve përkatëse në fuqi dhe akteve nënligjore lidhur me përditësimin e Programit për dhënien e provimit për agjentë dhe konstatoi se të njëjtat nuk kanë ndikim thelbësor mbi materien e përpunuar në Programin për provim të agjentëve nga nëntori i vitit 2022.

Gjatë vitit 2025 u organizua provim për agjentë në 5 sesione provimi, me ç'rast nga gjithsej 191 pjesëmarrës të pranishëm të paraqitur për dhënien e provimit, dhanë 104 ose 54% nga kandidatët e pranishëm.

Në kuadër të aktiviteteve lidhur me provimin për agjentë, sipas ligjit, Komisioni për verifikimin e pyetjeve kreu revizion të pjesëve të para dhe të dyta të provimeve për agjentë të mbajtura në vitin 2025, duke përfshirë edhe kontroll nëse provimin e kanë dhënë kandidatët të cilët i përmbushin kushtet për dhënien e provimit. Për revizionet e kryera Komisioni për verifikimin e pyetjeve përpiloi raporte përkatëse të cilat i dorëzoi deri te kryetari i Këshillit të ekspertëve të Agjencisë. Gjithashtu, sipas ligjit, e me qëllim që të përmirësohet cilësia e bazës së pyetjeve dhe shembujve praktikë, Komisioni për verifikimin e pyetjeve kreu revizion dhe përditësim, e gjithashtu ndryshoi ose plotësisht largoi dhe zëvendësoi me të reja të paktën 60% nga baza e pyetjeve dhe shembujve praktikë për vitin 2025.

Agjencia kreu regjistrim të gjithsej 58 agjentëve nga të cilët 17 agjentë të Sava shoqëria pensionore sh.a. Shkup, 9 agjentë të KB Shoqëria e parë pensionore SHA Shkup, 10 agjentë të Trigllav shoqëria pensionore SHA Shkup dhe 22 agjentë të VFP SHOQËRIA PENSIONORE SHA SHKUP. Regjistrim i sërishëm është kryer për 2 agjentë dhe atë të Sava shoqëria pensionore sh.a. Shkup dhe Trigllav shoqëria pensionore SHA Shkup. Gjithsej 6 agjentëve u pushoi statusi i agjentit prej të cilëve 1 agjent i KB Shoqëria e parë pensionore SHA Shkup, 4 agjentë të Sava shoqëria pensionore sh.a. Shkup dhe 1 agjent i Trigllav shoqëria pensionore SHA Shkup.

6 Zhvillimi i vetëdijes së publikut për qëllimet dhe parimet e sigurimit pensionor të financuar me kapital dhe të drejtat e anëtarëve të fondeve pensionore

Gjatë vitit 2025, Agjencia për mbikqyrjen e financimit kapital të sigurimit pensional(MAPAS) vazhdimisht zbatonte aktivitete të orientuara drejt avancimit të edukimit financiar, përfshirjes financiare dhe përforcimit të vetëdijes publike për rëndësinë e sigurimit pensionor të financuar me kapital. Aktivitetet u realizuan në kuadër të një qasjeje të koordinuar me institucionet anëtare të Trupit koordinues, ashtu edhe përmes nismave të pavarura sipas Programit për punë të Agjencisë, me pjesëmarrje aktive të shoqërive pensionore: KB Shoqëria e parë pensionore SHA Shkup, Sava shoqëria pensionore sh.a. Shkup, Trigllav Shoqëria pensionore SHA Shkup dhe VFP Shoqëria pensionore SHA Shkup, si dhe në bashkëpunim me institucione arsimore, komunitetin akademik dhe institucione dhe organizata tjera përkatëse. 21

Në kuadër të zbatimit të fushatës informative të Agjencisë, në periudhën nga korriku deri në dhjetor 2025 u realizuan aktivitete gjithëpërfshirëse të orientuara drejt avancimit të informimit publik, rritjes së shkrim-leximit financiar dhe përforcimit të vetëdijes për rëndësinë e sigurimit pensionor të financuar me kapital, me theks të veçantë mbi popullatën e re. Fushata filloi me vendosjen e një strukture organizative funksionale dhe definimin e drejtimeve të qarta komunikuese, bazuar në analizën e nevojave dhe karakteristikave të grupeve të synuara, me ç'rast vëmendje e veçantë iu kushtua adaptimit të terminologjisë profesionale në formë të kuptueshme dhe të qasshme, me qëllim bartje më efektive të porosive deri te publiku i gjerë. Në pjesën e krijimit të përmbajtjeve u zhvilluan më shumë koncepte dhe zgjidhje komunikuese,

duke i përfshirë skenarët për video edukative, materiale vizuale dhe përmbajtje tekstuale, të cilat siguruan qasje konsistente dhe të dallueshme në komunikim.

Aktivitetet e përfshinë praninë e vazhdueshme në mediat sociale përmes planifikimit, përgatitjes dhe publikimit të përmbajtjeve, si dhe analizën dhe optimizimin e tyre, me ç'rast përmbajtjet përgatiteshin dhe publikoheshin në gjuhën maqedonase dhe shqipe, me çka u siguroa gjithëpërfshirje dhe shtrirje më e gjerë e fushatës.

Përmes komunikimit sistematik dhe të vazhdueshëm, mediat sociale u pozicionuan si kanal përkatës për informim dhe edukim, me ç'rast u arrit shtrirje e konsiderueshme dhe nivel i lartë i ndërveprimit me shfrytëzuesit, gjë që kontribuoi për rritje të dukshmërisë së temave lidhur me sistemin pensionor dhe përforcim të besimit të publiku.

Në kuadër të fushatës u realizua edhe prodhim i gjerë i përmbajtjeve video, e cila e përfshiu përgatitjen, incizimin, montimin dhe finalizimin e videove edukative dhe informative, të adaptuara për platforma të ndryshme digjitale, si dhe adaptimin e tyre gjuhësor dhe vizual.

Shtesë u ndërmorën aktivitete për avancimin e pranisë në ueb përmes analizës dhe optimizimit të përmbajtjeve, me qëllim rritjen e qasshmërisë dhe dukshmërisë së tyre në internet dhe përmirësimin e komunikimit me shfrytëzuesit.

Përbërës veçanërisht të rëndësishëm paraqisnin ngjarjet dhe aktivitetet edukative të drejtpërdrejta, ndër të cilat ngjarja qendrore me rastin e Ditës së vetëdijes pensionore, si dhe një varg prezantimesh dhe punëtorish ndërvepruese në institucione arsimore, me çka u mundësua komunikim i drejtpërdrejtë me të rinjtë dhe kontribuoi për mirëkuptim më të mirë të sistemit pensionor dhe rëndësinë e tij.

Shtesë u realizuan aktivitete në kuadër të nismave për shkrim-lexim financiar, si dhe pjesëmarrje në konferenca, panele-diskutime dhe ngjarje edukative, me çka u përforcua bashkëpunimi me institucione përkatëse dhe u zgjerua shtrirja e aktiviteteve edukative.

Në pjesën e marrëdhënieve me publikun u zbatua komunikim aktiv me mediat, përmes përgatitjes dhe shpërndarjes së përmbajtjeve informative, si dhe pjesëmarrje në formate mediatike, me çka u siguroa promovim shtesë dhe dukshmëri e fushatës.

Paralelisht u përpunuan materiale të ndryshme informative dhe vizuale, me qëllim mbështetjen e aktiviteteve komunikuese dhe avancimin e dallueshmërisë vizuale, si dhe përforcimin e perceptimit publik për rëndësinë e sistemit pensionor.

Në kuadër të aktiviteteve të përbashkëta me shoqëritë pensionore, veçanërisht e rëndësishme ishte realizimi i fushatës së përbashkët informative „Mbill dëshirë për ardhmëri stabile“, e zbatuar nga KB Shoqëria e parë pensionore SHA Shkup, Sava shoqëria pensionore sh.a. Shkup dhe Trigllav Shoqëria pensionore SHA Shkup, e cila përfshiu krijimin e përmbajtjeve edukative, ridizajnim të platformave ueb, aktivitete mediatike, prani në rrjete sociale dhe organizim të ngjarjeve publike dhe konferenca.

Në kuadër të kësaj fushate u krijuan përmbajtje blogu, fjalor financiar, materiale video, si dhe aktivitete komunikuese përmes mediave tradicionale dhe digjitale, me çka u arrit shtrirje e konsiderueshme dhe ndërveprim me publikun dhe u avancua informimi për sigurimin pensionor të financuar me kapital. Në lidhje me aktivitetet individuale, VFP Shoqëria pensionore SHA Shkup realizoi më shumë aktivitete edukative përmes ligjëratave për nxënës, studentë dhe kuadër mësimdhënës, si dhe aktivitete në kuadër të shënimit të Ditës së vetëdijes pensionore dhe Ditëve të shkrim-leximit financiar, me çka u kontribua për zhvillim të sigurimit pensionor vullnetar dhe rritje të kulturës financiare te popullata.

Gjatë vitit u siguroa edhe komunikim i vazhdueshëm me anëtarët e fondeve pensionore përmes informimit të rregullt me informatorë elektronikë, si dhe përmes kanaleve digjitale, me çka u përforcua transparenca dhe informimi.

Përveç aktiviteteve kombëtare, Agjencia mori pjesë në mënyrë aktive edhe në nisma ndërkombëtare, takime pune dhe projekte në fushën e edukimit financiar dhe përfshirjes, me qëllim avancimin e sistemit dhe akordimin me praktikat ndërkombëtare.

Në fazën përfundimtare të fushatës u realizuan aktivitete lidhur me finalizimin e përmbajtjeve, përgatitjen e materialeve shtesë komunikuese dhe rumbullakimin e procesit të përgjithshëm, me çka u siguroa ndjekje e vazhdueshme dhe vlerësim i aktiviteteve të zbatuara.

Në tërësi, aktivitetet e realizuara në vitin 2025 kontribuan për rritje të konsiderueshme të informimit publik, avancim të shkrim-leximit financiar dhe ngritje të vetëdijes pensionore, si dhe për vendosjen e kanaleve të qëndrueshme komunikuese për edukim të mëtutjeshëm dhe informim të qytetarëve, me çka përforcohet besimi në sistemin pensionor dhe nxitet pjesëmarrja aktive e popullatës në planifikimin e ardhmërisë së vet financiare.

7 Analiza statistikore dhe përpilimi i raporteve për sigurimin pensionor të financuar me kapital

Agjencia në vitin 2025 vazhdimisht përpilonte analiza statistikore për sigurimin pensionor të financuar me kapital, përkatësisht për punën e shoqërive pensionore, fondeve pensionore të obligueshme dhe fondeve pensionore vullnetare.

Për atë qëllim rregullisht përpiloheshin dhe publikoheshin raporte statistikore dhe gjatë vitit 2025 u publikuan 12 buletine mujore, 4 raporte statistikore tremujore dhe një raport vjetor statistikor. Këto raporte përmbajnë të dhëna për shpërndarjen e anëtarësisë në fondet pensionore të obligueshme dhe vullnetare sipas statusit të tyre (anëtarë vullnetarë ose të obligueshëm në shtyllën e dytë përkatësisht anëtarë me llogari individuale vullnetare ose me llogari profesionale në shtyllën e tretë), për strukturën moshore dhe gjinore të anëtarësisë, për kontributet e paguara në shtyllën e dytë dhe të tretë, për kompensimet e arkëtuara dhe lartësinë e mjeteve neto të fondeve pensionore të obligueshme dhe vullnetare, për vlerën e njësive kontabël të fondeve pensionore të obligueshme dhe vullnetare dhe për strukturën e investimeve të fondeve pensionore të obligueshme dhe vullnetare.

Tremujore llogaritej dhe publikohej të ardhurat e realizuara të fondeve pensionore të obligueshme dhe vullnetare në shumë nominale dhe reale. Aktualisht, përkatësisht një herë në muaj, llogaritej edhe ponderi për shpërndarjen e të siguruarve të sapopunësuar të cilët janë përfshirë në sigurimin pensionor të obligueshëm të financuar me kapital, për çdo fond të veçantë pensionor të obligueshëm dhe i njëjti i dorëzohej Fondit të SPIM i cili e kryen shpërndarjen e të siguruarve.

Në vitin 2025 vëmendje e veçantë iu kushtua përpilimit të Raportit për gjendjet në sigurimin pensionor të financuar me kapital për vitin 2024, i cili është obligim ligjor i Agjencisë. Raporti përmban vështrim të shkurtër të përgjegjësive të Agjencisë, misionit dhe vizionit të saj, pasqyrë të shkurtër të gjendjeve botërore dhe trendeve në fushën pensionore me theks mbi sigurimin pensionor të financuar me kapital, përshkrim të strukturës së sigurimit pensionor të financuar me kapital, përshkrim të detajuar, informacione dhe të dhëna për punën financiare të shoqërive pensionore, pastaj vështrim të ndryshimeve dhe plotësimeve të akteve ligjore dhe nënligjore të cilat e rregullojnë sigurimin pensionor të obligueshëm dhe vullnetar të financuar me kapital. Pjesa më e madhe e raportit i është kushtuar informacioneve dhe të dhënave për fondet pensionore të obligueshme dhe vullnetare, përkatësisht Raporti përfshin informacione dhe të dhëna për anëtarësinë, kalimin midis fondeve, kontributet, investimin, mjetet, njësinë kontabël, kompensimet dhe pagesën e pensioneve dhe kompensimeve pensionore, veç e veç për çdo fond pensionor të obligueshëm dhe për çdo fond pensionor vullnetar. Raporti përmban edhe informacione lidhur me marketingun dhe agjentët e shoqërive pensionore.

Raporti u shqyrtua dhe u miratua nga Këshilli i ekspertëve të Agjencisë, pas së cilës u publikua në faqen ueb të Agjencisë dhe u shtyp dhe u dorëzua deri te personat dhe institucionet përkatëse. Gjithashtu, Raporti i cili është përpiluar dhe shtypur në gjuhën maqedonase ishte përkthyer dhe shtypur edhe në gjuhën angleze dhe shqipe.

Në vitin 2025 Agjencia vazhdoi me aktivitete për avancimin dhe digjitalizimin e publikimit dhe qasjes deri te të dhënat nga sigurimi pensionor i financuar me kapital përmes mirëmbajtjes së mjetit ueb statistikor MAPAS-STAT, mundësuar përmes Business Intelligence Tool - Metabase. Qëllimi i vendosjes së MAPAS-STAT është të sigurohet qasje më e thjeshtë dhe të rritet vëllimi dhe frekuenca e publikimit të të dhënave përkatëse statistikore për pjesëmarrësit, të gjitha palët e interesuara dhe publikun e gjerë. Përveç aktiviteteve të mësipërme lidhur me analizën statistikore, u realizuan edhe hulumtime dhe u përpiluan analiza krahasuese në tema përkatëse për sigurimin pensionor të financuar me kapital. Gjithashtu, aktualisht ndiqeshin të reja, trendet dhe lëvizjet në fushën pensionore dhe fusha tjera përkatëse me analiza të ndikimeve të tyre mbi sigurimin pensionor të financuar me kapital dhe mundësitë për zhvillim dhe avancim të sigurimit pensionor të financuar me kapital, për të cilat u përpiluan 4 raporte për të reja në nivel tremujor.

8 Ndërtimi dhe përforcimi i kapaciteteve të Agjencisë

8.1 Pjesëmarrja në seminare dhe konferenca dhe trajnime të specializuara në vend dhe jashtë vendit

Në vitin 2025 të punësuarit në Agjenci patën mundësi ta vazhdojnë edukimin e tyre profesional përmes pjesëmarrjes në procesin e trajnimeve dhe përmes vizitës së seminareve dhe konferencave. Gjatë vitit 2025 të punësuarit në Agjenci me prani fizike dhe përmes platformave elektronike virtuale të qasshme morën pjesë në seminare dhe konferenca, të organizuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe jashtë vendit dhe atë:

1. Takimi i 89-të i juristëve Ohër Dora-evolucioni i rezistencës digjitale - Zagreb;
2. Transformimi digjital i bankës Luksemburg;
3. Java e tregjeve financiare e OECD;
4. Prokurime publike dhe financa, zvogëlimi i rreziqeve nga ankesat, menaxhimi me kontratat për PP, ndërlidhja e planit për PP me planin financiar dhe përmirësimi i cilësisë së ankesave Itali; 26
5. Trajnim për prokurime publike Spanjë;
6. Ngjarja vjetore në kuadër të projektit me INFE - OECD - Sarajevë;
7. Konferenca e tretë vjetore për analizë teknike Rumani;

Gjatë vitit 2025 të punësuarit në Agjenci i vizituan trajnimet e specializuara në vijim të organizuara në vend dhe jashtë vendit dhe atë:

- Trajnim për siguri dhe shëndet në punë;
- Wordpress-programim, krijim i lehtë dhe menaxhim me faqe ueb;
- Kontrollat interne, menaxhimi me rreziqe dhe planifikim strategjik: të reja dhe aspekte kyçe;
- Aspekte juridike të inteligjencës artificiale;
- Financa të qëndrueshme në vendet e BE-së;

- Parandalimi dhe çrënjosja e dhunës dhe ngacmimit në vendin e punës;
- Zbatimi i ZAP dhe ZPP;
- Organizimi i brendshëm dhe ndryshimet e Aktit për sistematizim;
- Zbatimi i procedurave për prokurime publike;
- Trajnim për certifikim për prokurime publike;
- Excel i avancuar: funksione për punë zyre;
- Punëtori ndërvepruese për modele për rezervim dhe validimi i tyre;
- Samiti digjital i Ballkanit Perëndimor;
- Edukim për ligjin e ri për material arkivor dhe punë arkivore;

8.2 Zhvillimi i proceseve të biznesit dhe kapacitetit informatik të Agjencisë

Në vitin 2025, Agjencia vazhdoi t'i zhvillojë proceset e saj të biznesit lidhur me funksionimin e shtyllës së dytë dhe të tretë (përditësim dhe avancim).

Agjencia aktualisht kryente administrim të sistemit të saj informatik, optimizim të bazës operative të të dhënave, administrim dhe mirëmbajtje të bazës së të dhënave, të sistemeve operative dhe të sistemit harduerik, si dhe mirëmbajtje të softuerit aplikativ, në bashkëpunim me shtëpinë softuerike të angazhuar për mirëmbajtjen e tij.

Gjithashtu, aktualisht administrohej dhe mirëmbahej pajisja ekzistuese harduerike, e përbërë nga makina serverësh në të cilat punon softueri aplikativ, kompjuterët personalë dhe kompjuterët portativë.

Aktivitetet kryesore në vitin 2025, ishin si në vijim:

- Automatizimi i procesit për gjenerim të skedarëve VHV deri te Banka Popullore;
- Ndërlidhja me platformën për ndërveprueshmëri për krijim të letrave për personat e shpërndarë përkohësisht si dhe për përditësimin e adresave për personat e shpërndarë përgjithmonë;
- Plotësime të portalit për këmbim të dokumenteve-vendosja e procesit të ri për këmbim të dokumenteve nga MAPAS deri te shoqëritë;
- Përpilimi i raporteve për agjentët;

- Përpilimi i raporteve për pagesa të mjeteve nga shtylla e dytë;
- Përpilimi i raporteve për nevojat e kontrollit financiar, për pagesa dhe tejkalime;
- Vendosja e kontrollit të ri për detektim të hershëm të kontributeve të dyfishta;
- Përmirësimi i modulit për agjentët;
- Përmirësime të kontrolleve të vendosura tashmë;

8.3 Sistemi i integritetit

Gjatë vitit 2025 agjencia vazhdimisht i ka zbatuar dhe avancuar standardet dhe politikat e vendosura në kuadër të sistemit për integritet. Agjencia mbetet fuqishëm e përkushtuar ndaj transparencës, llogaridhënies dhe profesionalizmit, si dhe ndaj zbatimit konsekuent të parimeve të masave për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave.

Në atë drejtim, ndërmerren aktivitete aktuale për mirëmbajtje dhe përmirësim të mëtejshëm të mekanizmave të vendosur, duke i përfshirë ndjekjen e zbatimit të standardeve etike, avancimin e kontrolleve interne dhe përforsimin e vetëdijes të të punësuarit për rëndësinë e integritetit në punë. Agjencia edhe më tej do të vazhdojë me zhvillim dhe përforsim të sistemit për integritet, me qëllim sigurimin e ekzekutimit efikas, transparent dhe përgjegjës të kompetencave të saj.

8.4 Bashkëpunimi me institucione dhe organizata nga vendi dhe nga jashtë vendit

Për shkak të sigurimit të supervizimit dhe rregullativës efikase të sigurimit pensionor të financiar me kapital, Agjencia bashkëpunon me më shumë institucione nga sektori financiar dhe pensionor në vend dhe jashtë vendit. Agjencia ka të lidhura 20 memorandume për bashkëpunim, sipas të cilave palët kontraktuese këmbajnë përvoja të fituara në fushën e sigurimit pensionor të financiar me kapital, punën e fondeve pensionore, mekanizmat e supervizimit të fondeve pensionore dhe rregulloret e sjella dhe masat juridike të përcaktuara dhe të shqiptuara. Bashkëpunimi teknik përbëhet nga këmbimi i dokumenteve, ndihmë bilaterale me qëllim këmbimin e përvojave nga interesi i përbashkët, si dhe bashkëpunimi në fushën e edukimit, hulumtimit, trajnimeve dhe zhvillimit nga interesi i përbashkët.

8.5 Bashkëpunimi me institucione nga vendi

Gjatë vitit 2025 vazhdoi bashkëpunimi i rregullt me institucionet në vend me të cilat Agjencia ka të lidhura memorandume për bashkëpunim përmes realizimit të takimeve të punës për këmbim të përvojave, pjesëmarrjes në seminare dhe konferenca dhe këmbimit të rregullt të raporteve dhe të dhënave përkatëse.

Agjencia merr pjesë me përfaqësuesit e saj në punën e Trupit koordinues për edukim financiar dhe përfshirje financiare në Republikën e Maqedonisë së Veriut në të cilin anëtarësohen dhe vendosin bashkëpunim Agjencia për supervizimin e sigurimit pensionor të financiar me kapital, Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministria e financave e Republikës së

Maqedonisë së Veriut, Agjencia për supervizimin e sigurimeve dhe Komisioni për letra me vlerë. Qëllimi i Trupit koordinues është realizimi i aktiviteteve të cilat kanë për qëllim të ngritet niveli i shkrim-leximit financiar të popullatës në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe të promovohet miratimi i sjelljeve përkatëse financiare. Përmes vizionit të integruar dhe zbatimit të projekteve arsimore financiare dhe përmes kombinimit të përpjekjeve të të gjitha palëve të prekura do të kontribuohet drejt mirëqenies së popullatës dhe stabilitetit të sistemit financiar si dhe vendosjen e bashkëpunimit në plan rajonal dhe internacional në domenin e edukimit financiar.

Në prill të vitit 2020 institucionet rregullatore në Republikën e Maqedonisë së Veriut lidhën Memorandum për bashkëpunim ndërinstitucional për shkak të ruajtjes së stabilitetit financiar në përputhje me rekomandimet e FMN dhe BB. Agjencia u përfshi në angazhimin e përbashkët me rregullatorët financiarë, të udhëhequr nga BP, për identifikim me kohë dhe efikas të rreziqeve sistematike dhe marrjen e aktiviteteve për shkak të parandalimit dhe zvogëlimit të ndikimit të tyre mbi sistemin financiar. Me sjelljen e Ligjit për stabilitet financiar, në korrik të vitit 2022, u vendos korniza institucionale për vendosjen e politikës makropruidente në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Me ligjin, juridikisht u institucionalizua Komiteti për stabilitet financiar dhe iu ndanë kompetenca rregullatorëve të sistemit financiar. Me Strategjinë për zbatimin e politikës makropruidente në Republikën e Maqedonisë së Veriut u vendos korniza operative për zbatimin e politikës makropruidente nga ana e Komitetit për stabilitet financiar dhe rregullatorëve përkatës. Me strategjinë makropruidente përcaktohen qëllimet e ndërmjetme të politikës makropruidente dhe lidhen me treguesit bazë të cilët përdoren për identifikim dhe ndjekje të rreziqeve sistematike dhe instrumentet përkatëse makropruidente, definohet cikli i zbatimit të politikës makropruidente dhe marrja e masave makropruidente. Transparenca dhe mënyra e komunikimit të masave me publikun, si dhe bashkëpunimi dhe koordinimi i politikave. Me këto aktivitete gjithashtu, do të jetë shtesë e përforcuar rezistenca e sistemit financiar ndaj goditjeve, ndërsa institucionet përkatëse do të jenë edhe më të përgatitura për menaxhim me sfidat.

Në mars të vitit 2022 institucionet rregullatore nga sektori financiar në Republikën e Maqedonisë së Veriut lidhën Memorandum për bashkëpunim për krijimin e kushteve për mbështetje të zhvillimit të inovacioneve në sistemin financiar në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Me Memorandum vendoset sistem përmes të cilit rregullatorët në mënyrë të koordinuar do të veprojnë, secili në kompetencën e tij, lidhur me zbatimin e Strategjisë kombëtare për sektorin fintech. Bashkëpunimi midis nënshkruesve realizohet përmes pjesëmarrjes në punën e Komitetit për mbështetje të zhvillimit të inovacioneve në sistemin financiar, pjesëmarrjes në punën e Nënkomitetit për mbështetje gjatë zbatimit të rekomandimeve nga Strategjia, pjesëmarrjes në punën e Sekretariatit përgjegjës për mbështetje administrative të punës së Komitetit dhe Nënkomitetit, si dhe aktiviteteve të grupeve të punës si mbështetje në zbatimin e rekomandimeve nga Strategjia. Në prill të vitit 2023 u miratua Strategjia për rregullatorët për sektorin fintech e cila ka për qëllim të sigurojë kushte për mbështetje të inovacioneve në fushën e financave, me ç'rast duke e pasur parasysh mbrojtjen e konsumatorëve dhe investitorëve dhe stabilitetin e sistemit financiar. Strategjia për rregullatorët për sektorin fintech ka të bëjë me aspektet rregullatore lidhur me transformimin e sistemit financiar të udhëhequr nga sektori fintech dhe në të janë përfshirë rekomandime për rregullatorët. Zhvillimi i sektorit fintech është me rëndësi të madhe për përforcimin e ekonomisë së një vendi, para së gjithash për shkak të

potencialit të tij për rritje të përfshirjes financiare. Për qytetarët, zhvillimi i sektorit fintech do të thotë më shumë mundësi dhe shërbime financiare më të lira.

Agjencia gjithashtu merr pjesë me përfaqësuesin e saj në punën e grupit të punës të formuar për shkak të vendosjes së Sistemit evropian për statistikë të mbrojtjes sociale të integruar ESSPROS në Republikën e Maqedonisë së Veriut. ESSPROS paraqet metodologji të mbledhjes së të dhënave me qëllim që të sigurohet përshkrim i detajuar dhe koherent i mbrojtjes sociale. Në grupin e punës janë të përfshira të gjitha institucionet përkatëse të cilat janë të përfshira në procesin e sigurimit të përfitimeve me qëllim mbulimin e rreziqeve të caktuara përkatësisht nevojave të popullatës. Grupi i punës i definoi skemat sipas të cilave secili institucion do t'i dorëzojë të dhënat përkatëse deri te Enti Shtetëror i Statistikës, i cili pastaj do t'i dërgojë deri te EUROSTAT. Procesi i dorëzimit sipas metodologjisë së ESSPROS, të dhëna nga Agjencia deri te Enti Shtetëror i Statistikës, është i rregulluar me memorandum për bashkëpunim. Sipas këtij memorandum, në vitin 2025, Agjencia i dorëzoi të dhënat e definuara ESSPROS për vitin 2024.

8.6 Bashkëpunimi me institucione nga jashtë vendit dhe me organizata ndërkombëtare

Gjatë vitit 2025 vazhdoi bashkëpunimi i rregullt me institucionet jashtë vendit me të cilat Agjencia ka të lidhura memorandume për bashkëpunim, këmbim të rregullt të raporteve dhe të dhënave përkatëse, si dhe komunikim dhe këmbim të informacioneve sipas nevojës, për shkak të këmbimit të përvojave supervizore dhe çështjeve lidhur me rregullativën në vendet përkatëse.

Agjencia përmes përfaqësuesve të saj edhe në vitin 2024 mori pjesë në mënyrë aktive në përpilimin e Programit kombëtar për miratimin e së drejtës së Bashkimit Evropian dhe Raportin për përparimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe në takimet e punës dhe nënkomitetet për Treg të brendshëm dhe konkurrencë dhe Çështje ekonomiko-financiare dhe statistikë. Gjithashtu, përfaqësuesi i Agjencisë merr pjesë në përpilimin e Programit për reforma ekonomike të Republikës së Maqedonisë së Veriut e cila çdo vit i dorëzohet Bashkimit Evropian dhe fillimin e procesit negociues.

Si anëtare e Organizatës ndërkombëtare të supervizorëve të fondeve pensionore - IOPS, e cila ka rreth 90 vende anëtare dhe vëzhgues nga e gjithë bota të cilët i përfshijnë të gjitha nivelet e zhvillimit ekonomik dhe të cilat i bashkojnë të gjitha llojet e sistemeve pensionore të supervizimit, Agjencia rregullisht merr pjesë në konferencat dhe i shfrytëzon materialet dhe udhëzimet e përpiluara nga ky trup, me qëllim këmbimin e informacioneve dhe përvojave dhe ndjekjen e standardeve botërore dhe praktikave pozitive në fushën e supervizimit të fondeve pensionore. Agjencia i ndjek edhe standardet për supervizim të IOPS me qëllim avancimin e cilësisë dhe efektivitetit të supervizimit të fondeve private pensionore, me çka do të përforcohet zhvillimi dhe efikasiteti i tyre operativ dhe do të mundësohet burim i sigurt i pensionit. Gjithashtu, Agjencia në vitin 2025 rregullisht komunikonte me IOPS dhe dorëzonte informacione, të dhëna statistikore, komente dhe përgjigje të pyetësorëve, të nevojshme për materialet e punës dhe studimet krahasuese të IOPS.

Nga viti 2016 si pjesë e Trupit koordinues të institucioneve rregullatore për edukim financiar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Agjencia është anëtare e Rrjetit ndërkombëtar për edukim

financiar pranë Organizatës për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik (INFE-OECD). Rrjeti është formuar në vitin 2008 dhe anëtarë janë institucionet rregullatore, përkatësisht bankat qendrore, ministritë dhe agjencitë lidhur me supervizimin e sigurimeve, investimeve dhe sigurimit pensionor. Rrjeti paraqet platformë për mbledhjen e të dhënave për shkrim-lexim financiar, zhvillimin e analizave dhe raporteve krahasuese dhe krijimin e instrumenteve për politika lidhur me edukimin financiar.

9 Misioni i ekspertëve TAIEX vlerësimi i rezistencës ekonomike të sigurimit pensionor të financuar me kapital

Në kuadër të aktiviteteve të parashikuara drejt përmbushjes së qëllimit strategjik Përmirësimi i kapacitetit në drejtim të përforsimit të rolit të saj supervisor dhe rregullator në sigurimin pensionor të financuar me kapital në Agjencinë për mbikqyrjen e financimit kapital të sigurimit pensional (MAPAS) u realizua projekt misioni i ekspertëve përmes instrumentit të Bashkimit Evropian (BE) TAIEX.

Ky projekt paraqet vazhdim të misionit të mëparshëm me të cilin MAPAS vendosi kornizë për menaxhim me rreziqet për stabilitet financiar dhe politikë makropruidente. Qëllimi kryesor i këtij misioni të ekspertëve është të zbatohet teknikë për menaxhim me rreziqe për të vlerësuar ndikimin potencial të ngjarjeve ose skenarëve të pafavorshëm (goditje makroekonomike dhe financiare) mbi gjendjen financiare dhe rezistencën e sigurimit pensionor të financuar me kapital në Maqedoninë e Veriut. Identifikimi me kohë dhe efikas i rreziqeve sistematike dhe marrja e aktiviteteve për shkak të parandalimit dhe zvogëlimit të ndikimit të tyre mbi sistemin financiar janë kompetenca të reja të MAPAS të cilat dalin nga Ligji për stabilitet financiar dhe nga Strategjia për zbatimin e politikës makropruidente në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Misioni i ekspertëve u realizua në periudhën nga 27 deri më 31 tetor 2025 nga ana e ekspertëve Ivana Herceg, Udhëheqëse e Sektorit për rreziqe sistematike dhe mbrojtje të konsumatorëve dhe Mario Bambulloviq, Udhëheqës i Departamentit për rreziqe sistematike në Agjencinë kroate për supervizimin e shërbimeve financiare (HANFA). Misionin e ekspertëve e ndoqën gjithsej 11 pjesëmarrës, të punësuar në MAPAS.

Gjatë misionit të ekspertëve, pjesëmarrësit u njohën me konceptet bazë dhe qëllimet e testimit të rezistencës në kuadër të BE-së dhe Bordit evropian për rreziqe sistematike (ESRB), me metodologjinë dhe shfrytëzimin e analizës së sensitivitetit dhe analizës së skenarëve si dhe me përcaktimin e rreziqeve në sigurimin pensionor të financuar me kapital me kontribute të definuara. Pastaj, ishin përpunuar në detaje qëllimet dhe qasjet e stres testimit të fondeve pensionore, mënyra e identifikimit të goditjeve makroekonomike dhe financiare dhe menaxhimi dhe aktivitetet supervizore të MAPAS në kontekst të stabilitetit financiar. Gjithashtu, ishte prezantuar zbatimi i modeleve deterministike dhe stokastike, si dhe studime praktike të rastit simulime të goditjeve të tregut, analiza e rezultateve dhe integrimi i rezultateve në proceset supervizore.

Misioni i ekspertëve ishte i dedikuar për përforsimin e kapaciteteve të MAPAS në fushën e menaxhimit me rreziqe dhe testimit të rezistencës së fondeve pensionore, në përputhje me

standardet evropiane dhe paraqet hap të rëndësishëm në drejtim të avancimit të proceseve për ndjekje të rezistencës së sigurimit pensionor të financuar me kapital, si dhe në akordimin e mëtutjeshëm me standardet evropiane në fushën e stabilitetit financiar dhe menaxhimit me rreziqe.

10 Sistemi për menaxhimin me cilësinë dhe sistemi për menaxhimin me sigurinë e informacioneve

Agjencia në vitin 2012 zbatoi zbatim të kërkesave nga standardi ndërkombëtar ISO 9001:2008 dhe të njëjtën me sukses e rumbullakoi me certifikim nga ana e trupit certifikues DAS Certification Limited, të akredituar nga United Kingdom Accreditation Service (UKAS).

Gjatë vitit 2018 me zbatimin e versionit të ri të standardit ISO 9001:2015, Agjencia proceset e saj operative i akordoi me kërkesat. Sipas kërkesave të versionit të ri nga standardi janë identifikuar rreziqe në nivel të njësive organizative të cilat udhëhiqen në regjistër të rreziqeve. Ndryshimet më të reja janë pjesë e evolucionit aktual të këtyre standardeve, të cilat ndihmojnë në zgjidhjen e çështjeve kyçe siç janë: përdorim i gjerë i standardeve për më shumë sisteme për menaxhim në kuadër të institucionit, integrim i cilësisë në udhëheqjen e institucionit, si dhe lehtësim i përgjithshëm i zbatimit të standardeve. Ky sistem, i cili është konfirmuar nga MKD SERTIFIKAT, e tregon përgatitjen e Agjencisë për të dëshmuar se si punohet në institucion ku zbatohen parimet e sistemit të pjekur për menaxhim me cilësinë dhe ku demonstrohen obligimi dhe përkushtimi i fortë i Këshillit të ekspertëve të Agjencisë dhe të gjithë ekipit vazhdimisht ta përmirësojnë punën sipas revizionit të ri të standardit ISO 9001:2015, e në interes për vetë institucionin dhe për të gjitha palët e prekura.

Duke i ndjekur të rejat në punën me menaxhim me cilësinë, si institucion në Republikën e Maqedonisë së Veriut i cili i njehtë rëndësinë, domosdoshmërinë dhe përfitimet nga sistemi i vendosur për menaxhim me cilësinë, Agjencia në vitin 2025 vazhdoi me zbatim dhe realizim të të gjitha aktiviteteve të reja të cilat i dikton ky standard në punën e përditshme. U tregua dhe u konfirmua se sistem i zhvilluar mirë dhe i mirëmbajtur për menaxhim me cilësinë ka kontribut pozitiv për arritjen e qëllimeve në punë.

Gjatë vitit 2015, Agjencia e implementoi standardin ISO 27001:2013 për sistem për menaxhim me sigurinë e informacioneve dhe me sukses ishte certifikuar. Pastaj, gjatë vitit 2016 dhe 2017 filloi procesi i bashkimit (integritit) të sistemeve për menaxhim me cilësinë dhe menaxhim me sigurinë e informacioneve i cili përfundoi dhe me sukses zbatohet.

Përpjekjet të cilat i bën Agjencia për përmirësimin e cilësisë për menaxhim dhe sigurinë e informacioneve u treguan të suksesshme, ndërsa të njëjtat janë të rëndësishme jo vetëm për institucionin tonë por edhe për të gjitha palët e prekura.

Kryetari i Këshillit të ekspertëve

Remzi Bajrami

